



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 194

Tiranë – E enjte, 16 dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 117/2021, datë 25.11.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut..... 18501
Dekret i Presidentit nr. 13375, datë 13.12.2021	Për shpallje ligji..... 18506
Ligj nr. 118/2021, datë 25.11.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për zbatimin e programit për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit dhe hartimit në nivel përfundimtar dhe studimin e impaktit mjedisor në sektorin e infrastrukturave, ratifikuar me ligjin nr. 86/2016..... 18506
Dekret i Presidentit nr. 13376, datë 13.12.2021	Për shpallje ligji..... 18515
Ligj nr. 119/2021, datë 2.12.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 32, datë 5.11.2021, “Për miratimin e tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin e furnizimin nga dhe ndërmjet <i>Pfizer Export BV</i> dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave”..... 18516
Dekret i Presidentit nr. 13377, datë 13.12.2021	Për shpallje ligji..... 18516
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 3.12.2021	Për miratimin e garancisë shtetërore, në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., për kontratën e kredisë ndërmjet Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a., Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a., për financimin e kapitalit qarkullues në kuadër të nevojave për import të energjisë..... 18516

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 738, datë 3.12.2021	Për miratimin e garancive shtetërore, në favor të Raiffeisen Bank sh.a., për kontratat e kredisë ndërmjet Raiffeisen Bank, sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Group sh.a., Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL) sh.a., Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., për financimin e kapitalit punues në kuadër të nevojave për import të energjisë.....	18517
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 761, datë 9.12.2021	Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), ruajtjen dhe trajtimin e pyjeve të virgjëra ose pothuajse të virgjëra, si dhe kalimin e tyre në konservim të plotë.....	18518
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 762, datë 9.12.2021	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Ali Emini.....	18520
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 418/6, datë 14.12.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave Moravë”, Njësia Administrative Otllak, Berat.....	18520



LIGJ
Nr. 117/2021

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT, PËR NGRITJEN E PIKAVE
TË PËRBASHKËTA TË KALIMIT
KUFITAR NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.11.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13375, datë 13.12.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT
PËR NGRITJEN E PIKAVE TË
PËRBASHKËTA TË KALIMIT KUFITAR,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
SË VERIUT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në vijim të referuara si “Palët”),

duke vlerësuar marrëdhëniet miqësore, bashkëpunimin dhe fqinjësinë e mirë ndërmjet dy vendeve;

duke marrë parasysh vullnetin për të forcuar dhe zhvilluar më tej bashkëpunimin dypalësh;

me qëllim për të thjeshtezuar dhe lehtësuar procedurat dhe masat e lidhura me kontrollet kufitare të menaxhimit të qarkullimit ndërkuftar ndërmjet dy vendeve;

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

1. Objekt i kësaj Marrëveshjeje do të jetë vendosja e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar, në pikat e kalimit kufitar për trafikun rrugor ndërkombëtar përgjatë kufirit shtetëror, midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe kryerja e kontrolleve doganore dhe kontrolleve kufitare.

2. Në parim:

a) Në pikat e përbashkëta të kalimit kufitar, kontrollet doganore dhe kontrollet kufitare në dalje nga Republika e Shqipërisë, dhe kontrollet doganore dhe kontrollet kufitare në hyrje në Republikën e Maqedonisë së Veriut do të kryhen në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut;

b) Në pikat e përbashkëta të kalimit kufitar, kontrollet doganore dhe kontrollet kufitare në dalje nga Republika e Maqedonisë së Veriut, dhe kontrollet doganore dhe kontrollet kufitare në hyrje të Republikës së Shqipërisë do të kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) Kontrollet doganore dhe kontrollet kufitare kryhen 24 orë në ditë, çdo ditë të javës.



3. Duke përjashtuar sa parashikohet në paragrafin 2 (a) (b), kontrollet e skanerit kryhen aty ku ndodhet skaneri, sipas protokollit që do të miratohet sipas referimit në nenin 16.

Neni 2 Përkufizime

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje:

1. “Pika e Përbashkët e Kalimit Kufitar”, në vijim referuar si “PPKK”, është pika kompetente e kalimit kufitar ku autoritetet kufitare të të dyja Palëve kryejnë kontrolle doganore dhe kontrolle kufitare.

2. “Kontroll doganor” nënkupton kontrollin e trafikut kufitar ndërmjet shteteve të Palëve, që nënkupton zbatimin e të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të tjera të shteteve të Palëve, që zbatohen për kalimin e kufirit shtetëror nga udhëtarët, si dhe për importin, eksportin dhe tranzitin e mallrave, kontrollin e mallrave, mjetet e transportit, bagazhet e pasagjerëve dhe mallrat e tjerë që udhëtarët mbajnë ose kanë me vete, duke përfshirë edhe qarkullimin e sendeve me vlerë dhe instrumenteve fizike të pagesave të transferueshme.

3. “Kontroll kufitar” nënkupton kontrollet e personave dhe dokumenteve të udhëtimit, mjetet e transportit dhe objekteve në pikat e kalimit kufitar gjatë orëve fikse të punës, në lidhje me kalimin e synuar të kufirit shtetëror, ose menjëherë pasi të kalohet kufiri shtetëror, si dhe llojet e tjera të kontrolleve të personave, mallrave, shërbimeve, mjeteve të transportit, kafshëve dhe bimëve, dhe produkteve të tyre që kalojnë kufirin shtetëror që parashikohen nga legjislacioni kombëtar i shteteve të Palëve.

4. “Shteti i hyrjes” nënkupton shtetin e Palës që kryen kontrollin doganor dhe kontrollet kufitare të hyrjes.

5. “Shteti i daljes” nënkupton shtetin e Palës që kryen kontrollin doganor dhe kontrollet kufitare të daljes.

6. “Zona e Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar”, në vijim e referuar si “ZPPKK”, nënkupton zonë e caktuar, e siguruar në përputhje me legjislacionin kombëtar të shteteve të palëve, ku zyrtarët e të dy Palëve janë të autorizuar të kryejnë kontrolle doganore dhe kontrolle kufitare, në përputhje me kompetencat e tyre.

7. “Personeli/nëpunësit” nënkupton personat që kryejnë detyra në fushat e kontrolleve doganore dhe kontrolleve kufitare, si dhe personat përgjegjës për monitorimin e shërbimeve të autorizuar nga secila Palë, si më poshtë:

1. Për Republikën e Shqipërisë: punonjës të Policisë së Shtetit, të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë, nëpunës të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë - Administrata Doganore dhe zyrtarë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;

2. Për Republikën e Maqedonisë së Veriut: punonjës të policisë së Ministrisë së Brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut - Departamenti për Kufitarin dhe Migracionin, nëpunës të Ministrisë së Financave të Republikës së Maqedonisë së Veriut - Administrata Doganore, nëpunës të Ministrisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave, Inspektorati Shtetëror për Bujqësinë, Inspektimi Fitosantar, nëpunës të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

8. “Mallrat” nënkupton mallrat, mjetet e transportit dhe të mirat materiale që kontrollohen nga nëpunësit doganorë.

9. “Kontroll me një ndalesë” nënkupton kontrollin doganor dhe kontrollet kufitare të kryera nga nëpunësit e të dy shteteve në një pikë të vetme, në të njëjtën kohë, ku përpunohen të gjitha procedurat.

10. “Shteti pritës” nënkupton shtetin në territorin e të cilit autoritetet kompetente të shtetit fqinj kryejnë kontrolle doganore dhe kontrolle kufitare.

11. “Shteti fqinj” nënkupton shtetin e Palës tjetër, autoritetet kompetente të së cilës kryejnë kontroll doganor dhe kontrolle kufitare në territorin e shtetit pritës.

Neni 3 Qëllimi i Marrëveshjes

Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Palët angazhohen për thjeshtësimin dhe përshpejtimin e kontrollit doganor dhe kontrolleve kufitare, me qëllim lehtësimin e lëvizjes së shtetasve dhe mallrave.



Neni 4

Vendndodhja e PPKK-së

Palët do të bien dakord, në mënyrë të ndërsjellë, për vendndodhjet e pikave të përbashkëta të kalimit të kufirit.

Neni 5

Ligji i zbatueshëm

1. Në lidhje me kontrollet doganore dhe kontrollet kufitare të kryera në PPKK, Palët do të zbatojnë legjislacionin e tyre kombëtar. Shkelja e këtyre dispozitave në PPKK do të ketë të njëjtat pasoja juridike, sikur të kishin ndodhur në territorin e shtetit fqinj.

2. Detyrat zyrtare, që do të kryejnë nëpunësit e shtetit fqinj në PPKK, do të realizohen në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës të shtetit fqinj dhe do të konsiderohet se janë kryer në territorin e atij shteti.

3. Kurdoherë që nëpunësit e secilës nga Palët ndërmarrin veprime, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, zyrtari i shtetit pritës do të informohet menjëherë dhe ai/ajo do të sigurojë mbështetje nëse është e nevojshme.

Neni 6

Kontrolli doganor dhe kontrollet kufitare në hyrje-dalje

1. Shtetasit, automjetet dhe mallrat, të cilët hyjnë dhe/ose dalin nga territori i shteteve të Palëve, u nënshtrohen kontrolleve nga autoritetet përkatëse përgjegjëse, vetëm një herë, bazuar në parimin “një ndalesë një kontroll”, në hyrje dhe dalje njëri pas tjetrit, sipas legjislacionit kombëtar të secilit shtet të Palëve dhe në përputhje me këtë Marrëveshje, në vendet e caktuara për këtë qëllim.

2. Pas nisjes së procedurës së verifikimit doganor dhe kontrolleve kufitare në hyrje, punonjësit/nëpunësit e shtetit të daljes nuk janë më të autorizuar të kryejnë veprime të lidhura me kalimin e kufirit. Megjithatë, nëse pas nisjes së procedurës së verifikimit doganor dhe kontrolleve kufitare në hyrje ka dyshime për vepra penale ose nëse konstatohet se një person i cili duhet arrestuar ndodhet në zonë, nëpunësit e shtetit të daljes janë të autorizuar që të përsërisin procedurat e

verifikimit kufitar, pasi të kenë njoftuar paraprakisht nëpunësit e shtetit të hyrjes.

3. Me pëlqimin e përbashkët, në rastet e rrethanave të paparashikuara dhe të jashtëzakonshme, dhe kur ka një rrezik për sigurinë publike, Palët mund të bien dakord të pezullojnë parimin e kontrollit me një ndalim dhe të rivendosen kontrolle të rregullta.

4. Personat të cilët refuzohen nga nëpunësit/punonjësit e shtetit të hyrjes, nuk mund të refuzohen të kthehen në shtetin e daljes/originës.

5. Mallrat, importi i të cilave është ndaluar nga nëpunësit e shtetit të hyrjes, do të lejohen të kthehen në shtetin e daljes.

6. Të ardhurat e mbledhura nga nëpunësit e shtetit fqinj në formën e tarifave zyrtare, për qëllime të procedurave të kalimit të kufirit në territorin e shtetit, i kthehen shtetit të tyre përkatës dhe nuk i nënshtrohen rregullave të eksportit. Të hollat dhe letrat me vlerë, të konfiskuara nga nëpunësit e secilës nga Palët gjatë kryerjes së kontrollit doganor, si dhe mallrat ose mjetet e sekuestruara trajtohen në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palës dhe nuk u nënshtrohen rregullave të eksportit.

7. Gjatë zbatimit të masave të përmendura në paragrafët 4–6, nëpunësit e Palëve informojnë dhe ndihmojnë njëra-tjetrën.

Neni 7

Dokumenti i identitetit, uniformat dhe armët

1. Nëpunësit e shtetit fqinj, gjatë orarit të shërbimit në ZPPKK, do të mbajnë kartë identiteti zyrtare të shërbimit, që i jep nëpunësit të drejtën të hyjë në ZPPKK, të punojë në të dhe të kthehet në vendin fqinj. Megjithatë, kjo nuk ndalon autoritetet policore të vendit pritës që të refuzojnë hyrjen në ZPPKK për nëpunës të caktuar të vendit fqinj. Nëse një nëpunësi të vendit fqinj i është refuzuar hyrja në vendin pritës autoritetet përkatëse do të informojnë, pa vonesë, autoritetet përkatëse të vendit fqinj mbi refuzimin.

2. Nëpunësit e të dy Palëve do të mbajnë uniformën e shërbimit gjatë kohës që ata janë të pranishëm në ZPPKK. Në rastet përjashtimore dhe kur bihet dakord nga autoritetet kompetente, nëpunësit mund të mbajnë veshje civile, me



shenjën policia/doganat, të dukshme në anën e parme dhe të prapme të veshjeve, ose duke mbajtur dallueshëm kartat e identitetit.

3. Palët do të informojnë njëra-tjetrën për ndryshimet që mund të ndodhin sipas këtij paragrafi.

4. Nëpunësit e vendit fqinj do të mbajnë vetëm një armë të shkurtër shërbimi (armë brezi), nëse ata janë të autorizuar në këtë mënyrë nga legjislacioni kombëtar. Përveç kësaj, nëpunësit e policisë mund të mbajnë pranga, shkopinj gome dhe gaz lotsjellës, kur janë në detyrë në ZPPKK.

Neni 8

Përdorimi i forcës

1. Forca, duke përfshirë forcën vdekjeprurëse, mund të përdoret vetëm në rastet e mbrojtjes së nevojshme dhe nevojës ekstreme në bazë të legjislacionit kombëtar.

2. Përdorimi i forcës duhet të jetë në përputhje me rrezikun dhe nuk duhet të tejkalojë kufijtë e nevojës për situatën konkrete.

3. Nëpunësit e Palës fqinje kanë të drejtën të përdorin forcën fizike për të izoluar personat që prishin rendin në ZPPKK.

4. Autoritetet e shtetit pritës do të njoftohen për këto masa, pa vonesë, dhe, në rastet kur kërkohet, do të ofrojnë mbështetje.

Neni 9

Mbrojtja e personelit

1. Nëpunësit e të dy Palëve gëzojnë të njëjtin nivel mbrojtjeje kur kryejnë detyrat e tyre në ZPPKK.

2. Gjykatat e shtetit fqinj kanë juridiksionin për të vendosur rreth kërkesave për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga punonjësit e këtij shteti, në aspektin e zbatimit të ligjit në ZPPKK. Këto pretendime gjykohen mbi bazën e ligjit kombëtar të shtetit fqinj në palë.

3. Në rast shkeljeje disiplinore, nëpunësit ju nënshtrohen procedimit disiplinor sipas legjislacionit kombëtar të secilës Palë.

Neni 10

Detyrimet dhe pretendimet

Nëse një nëpunës i shtetit fqinj humb jetën ose plagoset në vendin e punës gjatë kryerjes së shërbimeve nga ana e tij dhe/ose në lidhje me këtë shërbim, ose nëse pëson dëmtime fizike të shkaktuara nga një send/objekt që ai/ajo mban me vete, pretendimet kompensohen në përputhje me ligjin kombëtar të shtetit fqinj.

Neni 11

Ambientet zyrtare

1. Shteti pritës merr përsipër sigurimin e ambienteve të nevojshme për nëpunësit e shtetit fqinj, për ushtrimin e funksioneve zyrtare.

2. Mjediset zyrtare të përdorura për kontrollin doganor dhe kontrollin kufitar nga të dyja Palët do të shënohen me shenja zyrtare dhe simbole shtetërore, në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

Neni 12

Mirëmbajtja e ambienteve zyrtare

Palët, gjithashtu, duhet të rregullojnë shpenzimet e tyre aktuale për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe mjediseve, si dhe shpenzimeve të tjera të përgjithshme.

Neni 13

Telekomunikacioni dhe pajisjet e tjera

1. Shteti pritës merr përsipër të miratojë instalimin e infrastrukturës telekomunikuese, të domosdoshme për të siguruar shërbimet e nevojshme të telekomunikacionit dhe informacionit.

2. Shteti pritës merr përsipër të mundësojë instalimin, zbatimin, komisionin dhe mirëmbajtjen e sistemeve, pajisjeve dhe pajisjeve të telekomunikacionit dhe informacionit, duke përfshirë mbikëqyrjen video dhe pajisjet e tjera elektronike të kërkuara vetëm për kontrollet doganore dhe kontrollet kufitare.

3. Funksionimi i sistemeve të telekomunikacionit dhe informacionit, dhe përdorimi i frekuencave do të jetë në përputhje me rregulloret e secilës Palë.



4. Autoritetet kompetente të Palëve në ZPPKK do të përdorin frekuencën, në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palëve.

5. Palët janë të detyruara të sigurojnë hapësirë të veçantë për ruajtjen e telekomunikacionit dhe sistemeve të informacionit siç kërkohet.

Neni 14

Pajisjet dhe objektet për përdorim zyrtar

1. Objektet dhe pajisjet që janë për përdorim zyrtar në ZPPKK, nga nëpunësit e vendit fqinj, do të përdoren dhe transportohen pa detyrime doganore. E njëjta gjë do të zbatohet për automjetet zyrtare dhe private të përdorura nga nëpunësit gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

2. Pajisjet zyrtare të të dyja Palëve, të nevojshme për të kryer detyra në lidhje me verifikimin kufitar, në ZPPKK, mund të instalohen dhe të përdoren nga nëpunësit e tyre respektivë.

3. Qentë e shërbimit të të dy Palëve do të konsiderohen si pajisje zyrtare dhe do të përdoren në përputhje me paragrafin 2, të këtij neni.

4. Palët do të informojnë njëra-tjetrën, menjëherë, për çdo lloj ndryshimi që mund të ndodhë në lidhje me paragrafët 1 dhe 2, nëpërmjet nëpunësve të tyre në ZPPKK.

5. Pala pritëse, përveç përjashtimit nga pagesa e detyrimeve, do të lejojë instalimin, zhvendosjen, mirëmbajtjen dhe përdorimin e pajisjeve të telekomunikacionit, që përdoren ekskluzivisht në veprimet e vendndodhjeve zyrtare të përcaktuara për kontrollin e kufirit nga nëpunësit e Palës fqinje dhe do të lejojë edhe lidhjen e këtyre pajisjeve me pajisjet përkatëse të Palës fqinje. Përdorimi i pajisjeve të tilla do të konsiderohet si trafik i brendshëm i Palës fqinje.

6. Letrat, korrespondencat zyrtare, dokumentet dhe mjetet e tjera që përmbajnë të dhëna të përdorura nga nëpunësit e secilës Palë, kur kryejnë detyrat në ZPPKK, si dhe posta zyrtare dhe pajisjet zyrtare nuk do të kontrollohen apo sekuestrohen nga nëpunësit e Palës tjetër.

Neni 15

Komiteti i Përbashkët i Ekspertëve

1. Në mënyrë që të monitorohet zbatimi i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të ngrenë Komitetin e Përbashkët të Ekspertëve (në

vijim KPE). Detyrat dhe punët e KPE-së do të rregullohen përmes rregullores së procedurave. Rregullorja e procedurave do të miratohet në mbledhjen e parë të KPE-së, e cila duhet të mbahet brenda 60 ditëve nga dita e fillimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Palët do të informohen përmes kanaleve diplomatike të caktimit të Kryetarit nga ana e tyre, të Komitetit të tyre të Përbashkët dhe kryetarët e komiteteve do të informohen për caktimin e anëtarëve të Komitetit të përbashkët dhe përfaqësuesit e tyre me shkëmbim notash.

2. KPE-ja do të përbëhet nga 5 (pese) përfaqësues të përhershëm nga secila Palë, të cilët përfaqësojnë institucionet përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

3. KPE-ja mblidhet rregullisht çdo gjashtë muaj. KPE-ja mund të mblidhet në çdo kohë, në rast kërkesë nga ndonjëra prej Palëve.

4. KPE-ja përcakton vendndodhjen e saktë të PPKK-së, si edhe parametrat e saj teknikë.

5. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, KPE-ja ka si detyrë të harmonizojë punën e autoriteteve kompetente në rregullimin e ambienteve, çështjeve teknike dhe të tjera, në lidhje me kalimet kufitare, si më poshtë:

- monitoron dhe analizon frekuencën e qarkullimit të trafikut dhe propozon masa dhe aktivitete për qarkullim më të shpejtë të njerëzve dhe mallrave;

- monitoron dhe analizon punën e shërbimeve kufitare kompetente dhe propozon masa për të përmirësuar funksionimin e kontrolleve të përbashkëta;

- kryen detyra të tjera që lidhen drejtpërdrejt me kontrollet e përbashkëta.

Neni 16

Aktet zbatuese dhe shtojcat

1. Në përputhje me këtë Marrëveshje dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e KPE-së, Palët bien dakord të nënshkruajnë protokollet zbatuese, të nevojshme, ndërmjet institucioneve përkatëse.

2. Protokollet përcaktojnë aspektet e lidhura me funksionimin e PPKK-ve, si edhe vendin dhe mënyrën në të cilën do të kryhen kontrollet e përbashkëta.



Neni 17

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhen nga KPE-ja/autoritetet kompetente të secilës Palë.

2. Në rast se brenda tre muajve KPE-ja nuk mund të arrijë në marrëveshje të pranueshme nga të dyja Palët, mosmarrëveshjet do të zgjidhen ndërmjet bisedimeve të ndërsjella, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 18

Dispozita e pezullimit

Për arsye sigurie kombëtare apo për mbrojtjen e interesit publik, secila prej Palëve mund të pezullojë përkohësisht zbatimin e Marrëveshjes apo të secilës prej dispozitave të saj në kushte të rrethanave që diktojnë një vendim të tillë në territorin e tyre. Pala tjetër njoftohet menjëherë me shkrim.

Neni 19

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të së cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, se procedurat e brendshme ligjore për hyrjen e saj në fuqi kanë përfunduar.

2. Kjo Marrëveshje nënshkruhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila Palë mund të zgjidhë këtë Marrëveshje në çdo kohë, nëpërmjet njoftimit me shkrim përmes kanaleve diplomatike. Në këtë rast Marrëveshja pushon së vepruari gjashtë muaj nga marrja e njoftimit nga pala tjetër për zgjidhjen e saj.

3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin me shkrim të Palëve. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje hyjnë në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

Nënshkruar në Tiranë, më 10 qershor 2021, në dy origjinale në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze, të tri tekstet njëloj të barasvlershme. Në rast të ndonjë mospërputhjeje lidhur me interpretimin, do të ketë përparësi teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E
MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Edi Rama

PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË
VERIUT
Zoran Zaev

DEKRET**Nr. 13375, datë 13.12.2021****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 117/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ**Nr. 118/2021**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE ME SHKËMBIM NOTASH
TË MARRËVESHJES NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË,
PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT PËR
PËRGATITJEN E STUDIMEVE TË
FIZIBILITETIT DHE HARTIMIT NË
NIVEL PËRFUNDIMTAR DHE
STUDIMIN E IMPAKTIT MJEDISOR NË
SEKTORIN E INFRASTRUKTURAVE,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 86/2016**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes ndërmjet



Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për zbatimin e programit për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit dhe hartimit në nivel përfundimtar dhe studimin e impaktit mjedisor në sektorin e infrastrukturave, ratifikuar me ligjin nr. 86/2016, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.11.2021

Shpallur me dekretin nr. 13376, datë 13.12.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

*Ambasada e Italisë
Tiranë*

Tiranë, 18.11.2020
Prot. 2738

NOTË VERBALE

Ambasada e Italisë në Tiranë i shpreh nderimet e saj Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe ka nderin t'i referohet notës verbale të Ministrisë shqiptare të Energjisë dhe Industrisë nr. 8287/3, datë 26 korrik 2018, me të cilën propozohet ndryshimi i disa pjesëve të Marrëveshjes midis qeverisë së Republikës Italiane, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e programit “*Project Facility për studimet e fizibilitetit dhe hartimin e nivelit përfundimtar dhe studimin e ndikimit mjedisor në sektorin e infrastrukturës*”, nënshkruar në Tiranë, më 12 prill 2016.

Ambasada e Italisë në Tiranë ka nderin të pranojë, në emër të qeverisë italiane ndryshimin e Marrëveshjes së lartpërmendur, në përputhje me nenin 14 të saj, siç specifikohet më poshtë:

- të zëvendësohet në të gjitha pjesët e tekstit origjinal, ku përmendet “Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës” me “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”;

- të zëvendësohet akronimi MTI me akronimin MIE;

- të zëvendësohet në të gjitha pjesët e tekstit origjinal, ku përmendet “Ministria e Financave Shqiptare” me “Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë shqiptare”;

- të zëvendësohet akronimi MFA me akronimin MFEA;

- të zëvendësohet, në të gjitha pjesët e tekstit origjinal, ku përmendet, “Njësia Teknike Lokale e Ambasadës së Italisë në Tiranë” me “Agjencinë Italiane për Bashkëpunimin për Zhvillim – Zyra e Tiranës”;

- të zëvendësohet akronimi UTL me AICS Tiranë.

Në hyrjen e Marrëveshjes, në të gjitha pjesët e tekstit origjinal, ku përmendet:

TË ELIMINOHEN aktivitetet e mëposhtme:

- Zgjerimi i rrugës aktuale që shkon nga Miloti në Shkodër;

- Realizimi i lidhjes direkte nga Vaqari (periferia e Tiranës) me Kavajën.

TË SHTOHEN aktivitetet e mëposhtme:

- Realizimi i rrugës Elbasan–Qukës;

- Realizimi i *By Pass*-it të Beratit.

Në nenin 3 “Përshkrimi i programit”:

TË ELIMINOHEN aktivitetet e mëposhtme:

- Zgjerimi i rrugës aktuale që shkon nga Miloti në Shkodër;

- Krijimi i lidhjes direkte nga Vaqari (periferia e Tiranës) me Kavajën.

TË SHTOHEN aktivitetet e mëposhtme:

- Ndërtimi i rrugës Elbasan–Qukës;

- Realizimi i *By Pass*-it të Beratit

Në nenin 8, “Kushtet financiare dhe metodat e livrimit të kredisë”

TË ZËVENDËSOHET:

- Fjalja “Kredia e ndihmës do të disbursohet në kushte financiare të tilla, që parashikojnë një normë koncesioni (*grant element*) prej 60% dhe një përqindje të zgjidhjes të barabartë me 2% të shumës totale” me “Kredia e ndihmës do të disbursohet në kushte financiare të tilla, që të parashikojnë një normë koncesioni (*grant element*) prej 60%, dhe një përqindje zgjidhjeje të barabartë me 35% të shumës totale”, që përbën 2%, një gabim në përqindjen e zgjidhjes.

- Në bashkëlidhjen 1, “Përmbledhje e programit”, në të gjitha pjesët e tekstit origjinal ku përmendet:



TË ELIMINOHEN aktivitetet e mëposhtme:

- Zgjerimi i rrugës aktuale që shkon nga Miloti në Shkodër;

- Krijimi i lidhjes direkte nga Vaqari (periferia e Tiranës) me Kavajën.

TË SHTOHEN aktivitetet e mëposhtme:

- Ndërtimi i rrugës Elbasan–Qukës;

- Realizimi i *By Pass*-it të Beratit.

Në bashkëlidhjen 1, në seksionin “Rezultatet e Pritshme” të zëvendësohet shprehja “janë përpiluar tri projekte të nivelit përfundimtar dhe S.I.A., në lidhje me sektorët rrugorë Milot–Shkodër, Vaqar–Kavajë dhe *By Pass* Elbasan” me shprehjen “Janë përpiluar tri projekte të nivelit përfundimtar dhe S.I.A., në lidhje me sektorët rrugorë Elbasan–Qukës, *By Pass* Berat dhe *By Pass* Elbasan”.

- Në bashkëlidhjen 3 “Plani Financiar”, të ZËVENDËSOHET:

- Zëri ref.1, Kredia e Ndhmës e parashikuar “350,000.00” me “450,000.00”.

- Zëri ref.2, Gara “Milot–Shkodër” me “Elbasan–Qukës”.

- Zëri ref 2, Kredia e Ndhmës e parashikuar: “750,000.00” me “1,050,000.00”.

- Zëri ref. 3, Gara “Vaqar–Kavajë” me “*By Pass* i Beratit”

- Zëri ref. 3, Kredia e Ndhmës e parashikuar “850,000.00” me “450,000.00”.

- Në të gjitha pjesët e tekstit original ku i referohet njësisë teknike për mbështetjen e programit:

- TË ELIMINOHET çdo referencë për personelin italian;

- Në bashkëlidhjen 3 “Plani Financiar”,

TË ELIMINOHET:

- Zëri ref. 4a.

TE ZËVENDËSOHET

- Zërit ref 4b, Kredia e Ndhmës së parashikuar “42,000” me “150,000”.

Ambasada e Italisë në Tiranë, ka, gjithashtu, nderin të propozojë në emër të qeverisë italiane:

1. Që bashkëlidhja 2 (Kritere të zgjidhshmërisë, klauzola etike, parime të përgjithshme të kontratave) të zëvendësohet me bashkëlidhjen e re 2 (klauzolat etike dhe parimet themelore për lidhjen dhe zbatimin e kontratave) bashkëlidhur kësaj Note Verbale;

2. Që në bashkëlidhjen 4 (Mënyrat e ekzekutimit dhe të administrimit të kredisë së butë): Seksioni II të eliminohet pika “Shuma e nevojshme

për asistencën teknike italiane do të gjendet në kuadër të kredisë së bute (shiko nenin 9 dhe bashkëlidhjen 3, pika 4) deri në një shumë prej 108,000.00 eurosh”.

Sipas parashikimeve të nenit 14 të Marrëveshjes së lartpërmendur, nëse Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e konsideron të pranueshme sa është propozuar më lart, kjo notë propozimi dhe Nota e përgjigjes së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme do të përbëjnë një Marrëveshje midis qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, e cila do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë nga dy njoftimet, me të cilat Palët do të komunikojnë zyrtarisht njëra-tjetrën mbi përfundimin e procedurave të tyre përkatëse të ratifikimit të brendshëm të parashikuar për këtë qëllim.

Ambasada e Italisë në Tiranë përfiton nga rasti t’i përsëritur Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ndjenjat e vlerësimit të saj më të lartë (*fjrmë, vullë*).

BASHKËLIDHJA 2 KLAUZOLAT ETIKE DHE PARIMET THEMELORE PËR LIDHJEN DHE ZBATIMIN E KONTRATAVE

Kjo shtojcë përcakton klauzolat etike dhe parimet themelore të cilave i përmbahet përzgjedhja e kontraktorit, lidhja dhe zbatimi i kontratës së furnizimeve, shërbimeve dhe punimeve të parashikuara nga Marrëveshja. Në rastet që nuk janë të përfshira në këtë aneks, aplikohet legjislacioni të cilit i referohet Marrëveshja.

1. KRITERET E KONTRAKTUESIT

1.1 Përveç rasteve të parashikuara në Marrëveshje, procedurat e zgjedhjes së kontraktuesit janë të hapura për operatorët ekonomikë të Bashkimit Evropian, për ata të përcaktuar nga neni 25 i direktivës 2014/24/UE dhe për ata që përmbushin kriteret dhe autorizimet e parashikuara nga legjislacioni vendës.

1.2 Autoriteti kontraktues mund t’i kërkojë operatorëve ekonomikë një ose më shumë prej kriterëve të mëposhtme të pjesëmarrjes, me kusht që t’i përmbahen dhe të jenë në proporcion me objektin e garës:



1.2.1 *Kapaciteti ekonomik dhe financiar*: Autoriteti kontraktues mund të vendosë kritere për të garantuar që operatorët ekonomikë të kenë kapacitetet ekonomike dhe financiare të nevojshme për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim, autoriteti kontraktues mund të kërkojë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro minimale vjetore të caktuar, duke përfshirë një xhiro minimale të caktuar në sektorin e aktivitetit objekt të kontratës, për sa kohë që nuk kalon dyfishin e vlerës së parashikuar të tenderit, përveçse në rrethana të motivuara, në lidhje me rreziqet specifike që lidhen me natyrën e punëve, shërbimeve ose furnizimeve. Për kontratat e ndara në pjesë, ky paragraf zbatohet për secilin lot. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mund të caktojë xhiron minimale vjetore që operatorët ekonomikë duhet të kenë në lidhje me grupet e lotëve, në rast se fituesit të tenderit i jepen disa lote për t'u zbatuar njëkohësisht.

1.2.2 *Kapaciteti teknik dhe profesional*: Autoriteti kontraktues mund të vendosë kritere për t'u siguruar që operatorët ekonomikë kanë burimet njerëzore dhe teknike dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me standardin e duhur të cilësisë. Në veçanti, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë që të kenë një nivel të mjaftueshëm të përvojës së dëshmuar me referencat e duhura në lidhje me kontratat e zbatuara më parë. Në procedurat e prokurimit për furnizime që kërkojnë punime vënieje në punë ose instalime, shërbime ose punë, aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të kryer këto shërbime mund të vlerësohet duke iu referuar kompetencës, efikasitetit, përvojës dhe besueshmërisë së tyre.

1.2.3 *Kualifikimi për të ushtruar aktivitetin profesional*: autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një regjistër profesional ose tregtar, të mbajtur në shtetin në të cilin janë themeluar ose inkorporuar.

1.3 Dokumentet e tenderit përcaktojnë kushtet e kërkuara të pjesëmarrjes, të cilat mund të shprehen si nivelet minimale të aftësisë dhe mjetet e përshtatshme të provës.

1.4 Nëse një operator ekonomik mbështetet në kapacitetet e palëve të tjera në lidhje me kriteret që lidhen me kapacitetin ekonomik dhe financiar, autoriteti kontraktues kërkon që operatori ekonomik dhe palët e sipërpërmendura të jenë bashkërisht përgjegjës për zbatimin e kontratës.

1.5 Në rastin e tenderave të punëve, të tenderave të shërbimeve dhe operacioneve të vendosjes në punë, ose instalimit brenda kornizës së një tenderi furnizimi, autoriteti kontraktues do të përcaktojë në dokumentet e tenderit detyrat thelbësore që duhet të kryhen drejtpërdrejt nga vetë fituesi i tenderit ose, në rastin e një oferte të paraqitur nga një grupim i operatorëve ekonomikë, nga një pjesëmarrës në grupim.

1.6 Konkurrentët përjashtohen nga pjesëmarrja në procedurat e tenderit dhe nuk mund të fitojnë ose të lidhin kontratat përkatëse, nëse:

1.6.1 Janë dënuar me vendim të formës së prerë për një nga arsyet e mëposhtme, siç përcaktohet në nenin 57(1) të direktivës 2014/24/BE: pjesëmarrje në një organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim, vepra terroriste ose vepra që lidhen me aktivitete terroriste, pastrim parash ose financim terrorist, puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore;

1.6.2 Janë dënuar me një dënim të formës së prerë për çdo krim tjetër nga i cili, si një dënim shtesë, rrjedh pamundësia për të kontraktuar me administratën publike të njëjës prej Palëve të kësaj Marrëveshjeje ose të Shtetit në të cilin ato janë themeluar ose inkorporuar;

1.6.3 Kanë kryer shkelje serioze, të vërtetuara në mënyrë përfundimtare, të detyrimeve në lidhje me pagesat e taksave ose të kontributeve të sigurimeve shoqërore, nëse kjo është vendosur nga një vendim gjyqësor ose administrativ me efekt përfundimtar dhe detyrues në një nga Palët e kësaj Marrëveshjeje ose në Shtetin në të cilin ndodhen themeluar ose inkorporuar;

1.6.4 Kanë kryer shkelje serioze, të vërtetuara në mënyrë përfundimtare, të detyrimeve në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë, me të drejtën mjedisore, sociale dhe atë të punës në një nga Palët e kësaj Marrëveshjeje ose në Shtetin në të cilin ato janë themeluar ose inkorporuar;

1.6.5 Ndodhen në një nga situatat e mëposhtme ose u janë nënshtruar procedurave për vlerësimin e falimentimit, likuidimin e detyrueshëm administrativ, marrëveshjen paraprake me kreditorët, pranimin me marrëveshje për vazhdimësinë e biznesit, ose janë në ndonjë situatë të ngjashme;

1.6.6 Janë gjetur fajtorë për vepra të rënda profesionale, të cilat autoriteti kontraktues është në gjendje t'i provojë me mjetet e duhura, të tilla që



bëjnë të dyshimtë integritetin ose profesionalizmin e tyre;

1.6.7 Ata ose subjektet që i përkasin të njëjtit grup juridik, anëtarë të konsorciumeve, shoqatave të përkohshme dhe nënkontraktuesve, janë në konflikt interesi lidhur me pjesëmarrjen e tyre në procedurën e prokurimit, duke i ofruar konsulencë autoritetit kontraktues apo subjektit, ose kanë marrë pjesë në përgatitjen e procedurës së tenderit;

1.6.8 U kanë lëshuar autoriteteve të njërit prej Shteteve Palë në këtë Marrëveshje deklarata të rreme, në lidhje me procedurën në vazhdim dhe në dhënien e nënkontratave, duke dhënë informacionin e kërkuar për verifikimin e mungesës së arsyeve të përjashtimit ose të pajtueshmërisë me kriteret e përzgjedhjes, ose kanë fshehur këto informacione, apo janë regjistruar në regjistrin e mbajtur nga Observatori i Autoritetit Kombëtar Antikorrupsion të Republikës Italiane për paraqitjen e deklaratave të rreme ose dokumentacionit të rremë, me qëllim lëshimin e certifikatës së kualifikimit.

1.6.9 Preken nga një shkak i rënies së të drejtës, pezullimi ose ndalimi të parashikuar nga legjislacioni i të dyja Palëve Kontraktuese në fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit;

1.6.10 Kanë qenë subjekt i sanksioneve që i ndalojnë të lidhin kontratë me administratën publike, për shkelje administrative, që rrjedhin si pasojë e veprave penale të vërtetuara me vendim përfundimtar dhe detyrues në një nga Palët e kësaj Marrëveshjeje ose në Shtetin në të cilin ato janë vendosur ose inkorporuar.

1.6.11 Kanë shkelur ndalimet e regjistrimit fiduciar të parashikuara në legjislacionin e njërit prej dy Palëve Kontraktuese në fushën e kontrollit të emrave për ndërmjetësit në kompanitë garantuese;

1.6.12 Nuk janë në përputhje me rregullat që rregullojnë të drejtën për punë të personave me aftësi të kufizuara, sipas legjislacionit të vendit të origjinës të autoritetit kontraktues;

1.6.13 Janë krahasuar me një pjesëmarrës tjetër në të njëjtën situatë garancie, në një situatë kontrolli ose në çfarëdolloj marrëdhënie, edhe *de facto*, nëse situata e kontrollit ose marrëdhënia do të thotë që ofertat t'i atribuohen një qendre të vetme vendimmarrëse;

1.6.14 Kanë lidhur kontrata punësimi ose vetëpunësimi dhe, në çdo rast, u kanë caktuar

detyra ish-punonjësve të autoritetit kontraktues, që kanë përfunduar marrëdhënien e tyre të punës prej më pak se tre vjetësh dhe të cilët në tre vjetët e fundit të shërbimit kanë ushtruar autoritet ose negociuar në emër të të njëjtit autoritet kontraktues ndaj të njëjtit operator ekonomik.

1.7 Një operator ekonomik duhet të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e tenderit edhe nëse arsyet e përjashtimit të parashikuara në paragrafin 1.6 kanë të bëjnë me një anëtar të bordit administrativ, menaxhues ose mbikëqyrës të këtij operatori ekonomik ose një person në të që ka kompetenca të përfaqësimit, vendimmarrjes ose kontrollit.

2. PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË KONTRAKTORIT

2.1 Dhënia dhe zbatimi i kontratave të punës, shërbimeve, pajisjeve dhe koncesioneve garantojnë cilësinë e shërbimeve dhe kryhen në përputhje me parimet e eficiencës ekonomike, efektivitetit, afateve kohore dhe korrektësisë. Në dhënien e kontratave dhe të koncesioneve, autoritetet kontraktuese, gjithashtu, respektojnë parimet e konkurrencës së lirë, mosdiskriminimit, transparencës, proporcionalitetit, si dhe të publicitetit. Parimi i eficiencës ekonomike mund të varet, në masën që lejohet shprehimisht nga rregulloret aktuale, nga kriteret, të parashikuara në njoftimin e tenderit, të frymëzuar nga nevojat shoqërore, si dhe mbrojtja e shëndetit, mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm, gjithashtu, nga pikëpamja energjetike.

2.2 Konceptimi i procedurave të prokurimit ose të koncesionit nuk mund të ketë qëllim të kufizojë artificialisht konkurrencën, në mënyrë që të favorizojë ose të disavantazhojë në mënyrë të parregullt disa operatorë ekonomikë ose disa punë, furnizime ose shërbime.

2.3 Kriteret për pjesëmarrje në tender duhet të jenë të tilla që të mos përjashtojnë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

2.4 Dokumentacioni i tenderit përcakton shumën e vendosur në bazë të tenderit për kontratën që do të jepet. Ofertat me shuma më të larta përjashtohen automatikisht.

2.5 Procedura e përzgjedhjes së kontraktorit anulohet nëse paraqiten më pak se tri aplikime/oferta të përshtatshme. Nëse kushtet objektive të tregut e bëjnë paraqitjen e tri ofertave



të përshtatshme shumë të pamundur, njoftimi i tenderit mund të lejojë fitimin edhe në prani të një ose dy ofertave të vlefshme.

2.6 Secili konkurrent nuk mund të paraqesë më shumë se një ofertë. Duke paraqitur ofertën e tyre në një tender, konkurrentët deklarojnë se nuk kanë ndonjë konflikt të mundshëm interesi dhe se nuk kanë ndonjë lidhje specifike me konkurrentë të tjerë ose me palë të tjera të përfshira në projekt.

2.7 Në mungesë të autorizimit të shprehur në dokumentacionin e tenderit, variantet e ofertës nuk janë të autorizuar. Variantet lidhen me objektin e tenderit.

2.8 Për pjesëmarrjen në procedurat e përzgjedhjes që i nënshtrohen autorizimit të AICS-së, autoriteti kontraktues kërkon nga ofertuesit të sigurojnë një garanci për një shumë të barabartë me 2% të shumës së vendosur në bazë të tenderit. Garancitë mund të jenë bankare ose siguracioni, duhet të parashikojnë shprehimisht heqjen dorë nga përfitimi i zbatimit paraprak të debitorit kryesor dhe të jenë operative, me kërkesë të thjeshtë me shkrim nga autoriteti kontraktues. Garancia zbatohet në rast të mosnënshkrimit të kontratës që i atribuohet fituesit të tenderit.

3. ZBATIMI I KONTRATAVE

3.1 Zbatimi i kontratave për kontratat që lidhen pas një procedure përzgjedhjeje, e cila i nënshtrohet autorizimit të AICS-së, garantohej nga një garanci bankare e barabartë me 10% të shumës së kontratës. Garancitë mund të jenë bankare ose siguracioni, duhet të parashikojnë heqjen dorë të shprehur nga përfitimi i zbatimit paraprak të debitorit kryesor dhe të jenë operationale, me kërkesë të thjeshtë me shkrim nga autoriteti kontraktues. Garancitë e zbatimit të kontratës duhet të parashikojnë, në dokumentacionin e tenderit, zbatimin në rast mashtrimi ose mospërbushjeje të rëndë nga zbatuesi. Garancitë e zbatimit lirohen në mënyrë progresive, sipas ecurisë së zbatimit dhe, në çdo rast, brenda kufirit maksimal prej 80% të shumës së garantuar. 20% i mbetur lirohet pas verifikimit të zbatimit të rregullt.

3.2 Kontratat mund të ndryshohen gjatë zbatimit me miratimin paraprak të AICS-së dhe brenda kufijve të përcaktuar në nenin 72 të direktivës 2014/24/BE. Sidoqoftë, shuma e ndryshuar nuk mund të tejkalojë burimet e përgjithshme financiare të parashikuara për zbatimin e Marrëveshjes. Miratimi i ndryshimeve

mund të refuzohet, nëse ato e bëjnë të pamundur ose jashtëzakonisht të pamundur ekzekutimin e të gjithë përbërësve të iniciativës të parashikuar në Marrëveshje. Kontraktorët nuk kanë të drejtë për asnjë pagesë ose rimbursim për ndryshimet e bëra pa autorizimin paraprak të AICS-së. Me kërkesë të AICS-së ose të autoritetit kontraktues, fituesi i tenderit, me shpenzimet e tij, do të rivendosë gjendjen.

3.3 Autoriteti kontraktor, nëse gjatë zbatimit bëhet e nevojshme për të rritur ose për të ulur shërbimet deri në një të pestën e shumës së kontratës, mund t'ia imponojë kontraktorit nën të njëjtat kushte të parashikuara në kontratën fillestare. Në këtë rast, kontraktuesi nuk mund të zgjidhë kontratën.

3.4 Kontratat nuk mund të transferohen te palët e treta, me penalitetin e zgjidhjes së kontratave sipas ligjit. Shitja është e pranueshme, pas miratimit të AICS-së, vetëm nëse te kontraktori fillestar hyn, për shkak të vdekjes ose pas ristrukturimit të shoqërisë, duke përfshirë blerjet, bashkimet, ndarjet, blerjet ose falimentimin, një operator tjetër ekonomik që plotëson kriteret e përcaktuara cilësore të përzgjedhjes, me kusht që kjo të mos nënkuptojë ndryshime të tjera thelbësore në kontratë dhe të mos synojë shmangien e zbatimit të kësaj shtojce.

3.5 Kohëzgjatja e kontratës mund të ndryshohet vetëm për kontratat në proces zbatimi, nëse parashikohet një mundësi zgjatjeje në dokumentet e tenderit. Në këtë rast, kontraktorit i kërkohet të kryejë shërbimet e parashikuara në kontratë me të njëjtat çmime, marrëveshje dhe kushte ose më të favorshme për autoritetin kontraktues.

3.6 Pa paragjykuar respektimin e detyrimeve të gjurmueshmërisë të referuara në paragrafin 3.9, transferimi i kredive nga korresponduesi i tenderit, i koncesionit, i konkursit të projektimit, janë efektive dhe të zbatueshme për Qeverinë Italiane vetëm me miratimin e AICS-së. Në çdo rast, autoriteti kontraktues, të cilit i është njoftuar transferimi, duhet të ruajë të drejtën për t'i paraqitur marrësit të gjitha kundërshtimet që mund t'i kundërvihen transferuesit, sipas kontratës në lidhje me punimet, shërbimet, furnizimet, projektin, të nënshkruara me të.

3.7 Titullarët e ngarkuar për projektin janë përgjegjës për dëmin e pësuar nga autoritetet kontraktuese si rezultat i gabimeve ose i



mosveprimeve të projektimit. Në rastin e kontratave që kanë si objekt projektimin ekzekutiv dhe zbatimin e punimeve, kontraktuesi është përgjegjës për vonesat dhe kostot që rezultojnë nga nevoja për të futur ndryshime, për shkak të mangësive në projektin e zbatimit.

3.8 Nënkontraktimi lejohet deri në maksimum 30% të vlerës totale të kontratës. Dokumentacioni i tenderit përcakton kushtet e nënkontraktimit. Konkurrentët duhet të deklarojnë në ofertat e tyre se cilat furnizime, shërbime ose punë synojnë të nënkontraktojnë. Fituesit e tenderit depozitojnë kontratat e nënkontraktimit tek autoriteti kontraktues përpara fillimit të punëve objekt të nënkontratës. Kontraktorët kryesorë marrin përsipër përgjegjësinë e plotë për gjithë kontratën ndaj autoritetit kontraktues. Nënkontraktorët duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1.2, në lidhje me shërbimet që do të duhet të ofrojnë dhe të mos bien në arsyet e përjashtimit të parashikuara në paragrafët 1.6 dhe 1.7. Konkurrenti ose kontraktori zëvendësojnë nënkontraktorët që ndeshen me arsye përjashtimi.

3.9 Çmimet kontraktuale shprehen dhe paguhen në euro ose në monedhë tjetër të parashikuar shprehimisht në Marrëveshje. Rreziqet dhe ndryshimet në kursin e këmbimit nuk do të jenë subjekt i ndonjë kompensimi në këtë rast.

3.10 Pagesat bëhen me metoda të gjurmueshme, sipas afateve kontraktuale që marrin parasysh ecurinë aktuale të zbatimit. Qeveria Italiane kryen akreditimet të Pala tjetër Kontraktuese e parashikuar nga Marrëveshja në një llogari bankare të dedikuar ekskluzivisht për zbatimin e Marrëveshjes. Kontratat përfshijnë një klauzolë që detyron kontraktorin, nënkontraktuesit dhe nënkontraktorët të përdorin për pagesa një llogari bankare të dedikuar.

3.11 Kontrata ndërpritet me ligj nëse fituesit e tenderit u nënshtrohen procedurave të falimentimit, likuidimit të detyrueshëm, administrimit gjyqësor ose marrëveshjes me kreditorët, ose gjenden në ndonjë situatë të ngjashme, duke ndjekur një procedurë të parashikuar nga legjislacioni përkatës kombëtar.

3.12 Në rastin e dashjes ose të fajit të rëndë, nuk lejohet asnjë kufizim i përgjegjësisë së kontraktuesve, nënkontraktuesve ose nënkontraktorëve.

3.13 Ekzekutimi i kontratës rregullohet nga ligji kombëtar i autoritetit kontraktues, përveçse kur parashikohet ndryshe në Marrëveshje dhe në këtë shtojcë.

3.14 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis ofertuesve të suksesshëm dhe autoritetit kontraktues nuk i nënshtrohet juridiksionit italian.

3.15 Dokumentacioni i tenderit duhet të përmbajë parimet e mësipërme.

4. SHPENZIME TË PRANUESHME DHE TË PAPRANUESHME

4.1 Shpenzimet e zbritura në kontrata janë të pranueshme nëse janë aktuale, të drejta dhe të nevojshme për të realizuar projektin, sipas dokumentit të projektit.

4.2 Në çdo rast, nuk janë të pranueshme shpenzimet, në lidhje me:

4.2.1 Mallra jo të nevojshme ose luksoze;

4.2.2 Mallra, shërbime dhe punë civile të lidhura drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt me aktivitete ushtarake;

4.2.3 Taksat, tatimet indirekte, përfshirë TVSH-në dhe detyrimet doganore që rrjedhin nga Shteti të cilit i përket autoriteti kontraktues;

4.2.4 Amortizimin e borxheve të kontraktuara më parë dhe humbjet e ardhshme të autoritetit kontraktues ose të përdoruesve të fundit;

4.2.5 Interesat për palët e treta nga autoriteti kontraktues ose përdoruesit e fundit.

5. KLAUZOLAT ETIKE

5.1 Çdo përpjekje nga konkurrentët (potenciale ose jo) për të marrë informacion konfidencial, për të lidhur marrëveshje të paligjshme me konkurrentë të tjerë ose për të ndikuar autoritetin kontraktues në fazën e analizës, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, do të rezultojë në përjashtim nga tenderi dhe si pasoje eliminimin e ofertës së tij.

5.2 Personeli që operon në administratën publike i Palëve Kontraktuese të Marrëveshjes, pavarësisht nga pozicioni specifik administrativ në të cilin ndodhet, nuk mund të punësohet si ekspert ose konsulent nga operatorët ekonomikë që marrin pjesë në tender.

5.3 Fituesit e tenderit duhet të veprojnë gjithmonë në mënyrë të paanshme dhe si këshilltarë besnikë, në përputhje me kodin e mirësjelljes së profesioneve të tyre përkatëse. Ata nuk bëjnë deklaratat publike mbi projektin ose mbi shërbimet e kërkuara atyre pa miratimin paraprak të autoritetit kontraktues. Në çdo rast, ato nuk e



angazhojnë autoritetin kontraktues, në asnjë mënyrë pa pëlqimin e tij paraprak me shkrim.

5.4 Për gjithë kohëzgjatjen e kontratës, fituesit e tenderit respektojnë të drejtat e njeriut dhe marrin përsipër të mos shkelin parimet politike, kulturore dhe fetare, zakonet dhe traditat e vendit përfitues. Në veçanti, kontraktorët respektojnë standardet themelore të punës të vendosura nga konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në fuqi për vendin partner dhe për Italinë. Në çdo rast, sigurohet respektimi i dispozitave të “Konventës për Lirinë e Sindikatave dhe Mbrojtjes së të Drejtës Sindikale”, “Konventës për të Drejtën e Organizimit dhe Bisedimeve Kolektive”, “Konventës për Punën e Detyruar”, të plotësuar nga Protokoll i vitit 2014, “Konventës për diskriminimin (punësimi dhe profesioni)”, të “Konventës mbi format më të këqija të punës së fëmijëve”, të “Konventës për mbrojtjen e mëmësisë”, “Konventës për sigurinë dhe shëndetin në bujqësi”, të “Konventës kuadër për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

5.5 Fituesit e tenderit nuk pranojnë pagesa të lidhura me kontratën, përveç atyre të parashikuara në të. Fituesit e tenderit nuk kryejnë ndonjë aktivitet ose marrin ndonjë avantazh nga autoriteti kontraktues, që nuk është në përputhje me detyrimet e tyre përkatëse kontraktuale.

5.6 Fituesit e tenderit ruajnë sekretin profesional për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës dhe madje edhe pas përfundimit të saj. Të gjitha raportet dhe dokumentet e hartuara ose të marra nga fituesi i tenderit janë konfidenciale.

5.7 Fituesit e tenderit shmangin çdo marrëdhënie që mund të kompromentojë pavarësinë e tyre ose të stafit të tyre, apo ndonjë konflikt tjetër interesi. Nëse fituesit e tenderit nuk mbeten më të pavarur ose lindin konflikte interesi gjatë zbatimit, ata, menjëherë, informojnë autoritetin kontraktues. Autoriteti kontraktues mund ta zgjidhë kontratën pa njoftim paraprak dhe pa pretendime për kompensimin e dëmeve nga ana e fituesit të tenderit.

5.8 Qeveria Italiane rezervon të drejtën të pezullojë ose të anulojë financimin e projektit, nëse shfaqen praktikatat të korrupsionit të çdo lloji, në ndonjë fazë të procedurës së dhënies së tenderit dhe, nëse autoriteti kontraktues nuk është në gjendje të marrë të gjitha masat e duhura për të rregulluar situatën e krijuar. Për qëllimet e kësaj

klauzole, “praktika korruptive” janë ofertat e rryshfetit, dhuratave, donacioneve ose komisioneve, të destinuara si një nxitje ose shpërblim për çdo person që ka kryer, ose është frenuar të kryejë, çdo veprim në lidhje me besimin ose realizimin e një kontrate tashmë të lidhur me autoritetin kontraktues.

5.9 Dokumentacioni i tenderit dhe kontratat përfshijnë një klauzolë që parashikon anulimin e tenderit ose zgjidhjen e kontratës tashmë të lidhur edhe nëse është në proces zbatimi e sipër ose e zbatuar tashmë, nëse dhënia ose ekzekutimi i kontratës ka shkaktuar shpenzime tregtare të pazakonta. “Shpenzime tregtare të pazakonta” janë komisionet që nuk përmenden në kontratën kryesore ose që nuk rrjedhin nga një kontratë e lidhur në mënyrë korrekte dhe referuar kontratës kryesore, komisionet e paguara që nuk ndjekin shërbime të ligjshme dhe të ofruara aktualisht, komisione të paguara në një parajsë fiskale, komisione të paguara një përfituesi jo të identifikuar mirë ose komisione të paguara një kompanie fasadë.

5.10 Fituesit e tenderit, me kërkesë të AICS-së, ofrojnë prova për të shpjeguar kushtet në të cilat është zbatuar kontrata. Autoritetet kompetente të Republikës Italiane mund të kryejnë çdo kontroll, në dokumentacion ose në vend, të cilin e konsiderojnë të nevojshëm për të mbledhur prova në rastet e dyshimeve të shpenzimeve të pazakonta tregtare ose praktikave të dyshimta korruptive.

5.11 Fituesit e tenderit që kanë paguar shpenzime të pazakonta tregtare në projektet e financuara nga fondet italiane i nënshtrohen, në varësi të seriozitetit të fakteve të gjetura, zgjidhjes së kontratës, ose përjashtimit të përhershëm nga marrja e pagesave me fonde të qeverisë italiane.

5.12 Mosrespektimi i një ose më shumë klauzolave etike nga konkurrenti ose fituesi i tenderit mund të rezultojë në përjashtimin e tyre nga kontrata të tjera të financuara, pjesërisht ose plotësisht me fonde italiane për ndihmën për zhvillim dhe zbatimin e sanksioneve të parashikuara në kontratë. Individidi ose kompania e mbajtur përgjegjëse duhet të informohet me shkrim për faktin.

5.13 Autoriteti kontraktues siguron që procedurat e blerjes për mallra, shërbime dhe punë të kryhen në një mënyrë transparente, bazuar në



kritere objektive dhe pavarësisht nga ndonjë ndikim i jashtëm.

BASHKËLIDHJA 4 MËNYRAT E EKZEKUTIMIT DHE E ADMINISTRIMIT TË KREDISË SË BUTË

SEKSIONI I. PUBLIKIMI I NJOFTIMIT TË GARËS, PROCEDURA E APLIKUAR

Dokumentacioni duhet të paraqitet në përputhje me sa është parashikuar në Manualin e Procedurave (PRAG miratuar nga Komisioni Evropian – varianti mars 2011, me shtojcat përkatëse që u përkasin dokumenteve të garës për shërbime dhe furnizime), përfshirë ndryshimet eventuale të mëvonshme, përveç pjesës që lidhet me rregullat e shtetësisë dhe origjinës, e cila do të aplikohet në përputhje me specifikat e kredisë ndihmëse italiane lidhur me Tenderimin e Shërbimeve, në kuadër të bashkëpunimit komunitar me vende të treta, si dhe me sa përcaktohet në shtojcën 2. Dokumentacioni, në çdo rast, duhet të:

- përcaktojë “kushtet e veçanta” lidhur me secilën garë;
- të bëjë të qarta kriteret e vlerësimit që do të aplikohen nga Komisioni i ngritur nga MIE.

Metodologjia

1. Përgatitja e dokumentacionit të garës

MIE do të përgatisë dokumentacionin e garës për përzgjedhjen e kujdestarëve (shërbimet e inxhinierisë). Ky dokumentacion gare, pasi të verifikohet dhe/ose integrohet nga AICS-ja, Zyra Tiranë, do t'i përcillet më pas zyrtarisht nga MIE Ambasadës/AICS Zyra Tiranë, së bashku me kërkesën e publikimit të njoftimit të garës në gazetën italiane.

2. Verifikimi i pajtueshmërisë së dokumentacionit të garës

Dokumentacioni i garës, i verifikuar dhe/ose i integruar, do t'i përcillet nga MIE Ambasadës/AICS-së, Zyra Tiranë, së bashku me kërkesën e publikimit të njoftimit për garën në shtypin italian, për verifikimin e pajtueshmërisë së tij me këtë Marrëveshje. Verifikimi përfundimtar do të kryhet nga AICS-ja dhe do të përqendrohet kryesisht në pajtueshmërinë e:

- procedurës së garës në raport me planin financiar të miratuar nga palët;

- përmbajtjeve me karakter ligjor në raport me procedurat e parashikuara nga shtojca 2;

- specifikave teknike dhe parametrave të vlerësimit, në raport me objektivat që propozohen të arrihen nga programi.

3. Publikimi i njoftimeve

Në rast të verifikimit me rezultat pozitiv, njoftimet e garës do të publikohen nga AICS-ja në gazetën kryesore të shtypit italian dhe në faqen e internetit të AICS-së. MIE do të procedojë njëkohësisht me publikimin e njoftimeve të tenderit në gazetën kombëtare të shtypit shqiptar.

SEKSIONI II. FAZA E ÇAKTIMIT TË FITUESIT TË GARËS – PROCEDURA APLIKUESE

Përfundimi i garave dhe verifikimi i përputhshmërisë së kriterëve të miratuara nga Komisioni i Vlerësimit:

- MIE do të ngrejë një Njësi Teknike të përbërë nga një personel teknik i kualifikuar, i cili do të veprojë si përfaqësues i Autoritetit Kontraktues

- Njësia teknike do të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm për fillimin e garave përkatëse. Ky dokumentacion duhet të përgatitet në përputhje me Manualin e Procedurave (PRAG i miratuar nga Komisioni Evropian - varianti i fundit) dhe anekset përkatëse, përveç pjesës që lidhet me rregullat për kombësinë dhe origjinën që do të miratohet në përputhje me specifikat e kredisë italiane të ndihmës, si dhe nga ato që specifikohen në shtojcën 2.

- Shuma e nevojshme për njësinë teknike dhe stafin e saj e barabartë me 150.000 euro, do të merret në kuadër të kredisë së ndihmës (shih nenin 9 dhe aneksin 3, pika 4b).

- MIE, përmes njësisë teknike, përgjegjëse për monitorimin e projekteve që përfitojnë nga fondet ndërkombëtare, do të ndjekë ecurinë e garave, duke ndihmuar, gjithashtu, Komisionin për vlerësimin e ofertave (të caktuar nga MIE).

- Pasi të përfundojë vlerësimin, para shpalljes së fituesit, MIE do t'i kërkojë AICS-së verifikimin e pajtueshmërinë të tenderit.

Metodologjia

1. Shqyrtimi i ofertave të ardhura për secilin tender do të kryhet nga një Komision Vlerësimi i ngritur posaçërisht nga MIE. Në hapjen e ofertave, dhe në çdo rast në të gjitha seancat publike të Komisionit të Vlerësimit, mund të marrë pjesë si



vëzhgues një përfaqësues i caktuar nga Ambasada/Zyra e AICS-së Tiranë.

2. Për secilën garë, MIE do t'i dërgojë Ambasadës/AICS-së, selisë së Tiranës, dokumentacionin që përmban aktet e Komisionit së bashku me kontratën që do të përcaktohet dhe kërkesën për autorizimin e lidhjes së kontratës. Ky dokumentacion do t'i dërgohet AICS-së nga ambasada/AICS-ja në Tiranë, me komente.

3. AICS-ja, kryesisht do të verifikojë pajtueshmërinë ligjore dhe teknike të vlerësimeve të kryera me procedurat dhe kriteret/parametrat e parashikuar në specifikimet e garës.

4. Sapo të përfundojnë verifikimet, AICS-ja do të informojë ambasadën/selinë e AICS-së në Tiranë për rezultatin e tyre.

5. Ambasada/AICS, Zyra e Tiranës do t'i komunikojë MIE-s rezultatin e kontrolleve që AICS-ja ka kryer.

6. Në rast të një rezultati pozitiv (*autorizimi*), MIE do të vazhdojë me lidhjen e kontratave me kompanitë fituese.

Seksioni III. FAZA E ALOKIMIT FINANCIAR TË KONTRATAVE DHE TË DISBURSIMIT – PROCEDURA E APLIKUAR

1. Kontratat e formalizuara ndërmjet shoqërive fituese dhe MIE-s do t'i përcillen AICS-së nëpërmjet ambasadës/AICS-së, Zyra Tiranë, të shoqëruara nga një deklaratë angazhimi e palës shqiptare për të përballuar kostot lokale lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar, taksat doganore etj.

2. Pas verifikimit të përputhshmërisë së kontratës me dokumentet e garës, AICS-ja do t'i dërgojë Drejtuesit të Fondit Rrotullues mungesën e pengesave për alokimin e kontratës, sipas Marrëveshjes Financiare.

3. Porsa të marrë miratimin e mungesës së pengesave sipas pikës 2, Drejtuesi i Fondit të Rrotullues do të plotësojë procedurën e shqyrtimit, duke i kërkuar fituesit që mallrat që do të blihen në fund të paraqitjes profesionale dhe/apo shërbimeve dytësore të jenë me prejardhje italiane. Në vijim të rezultatit pozitiv të shqyrtimit të mësipërm, si dhe marrjes së kërkesës të financimit nga ana e Huamarrësit, *Artigiancassa* do t'i komunikojë huamarrësit dhe AICS-së, vendosjen dhe financimin e kontratës, sipas Marrëveshjes Financiare.

4. Drejtuesi i Fondit Rrotullues do të fillojë të japë paradhënie të pagesës, sipas përcaktimeve në

kontratë, pasi të ketë marrë kërkesën për disbursim nëpërmjet dokumentacionit administrativ të bashkëlidhur, sipas planit (*fatura tregtare, packing list, bill of lading etj.*) dhe pasi të ketë verifikuar përputhshmërinë e këtij dokumentacioni me kontratën e autorizuar. Një kopje e kërkesës së disbursimit do t'i dërgohet edhe Huamarrësit. Pagesat do të disponohen vetëm pas lëshimit të autorizimit, për të vijuar nga ana e Huamarrësit: ky autorizim duhet që, gjithsesi, të përcillet brenda 30 ditëve nga data e kërkesës individuale të disbursimit.

DEKRET

Nr. 13376, datë 13.12.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 118/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për zbatimin e programit për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit dhe hartimit në nivel përfundimtar, dhe studimin e impaktit mjedisor në sektorin e infrastrukturave, ratifikuar me ligjin nr. 86/2016.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Ilir Meta

**LIGJ**
Nr. 119/2021

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 32, DATË
5.11.2021, “PËR MIRATIMIN E TEKSTIT
TË DISA NDRYSHIMEVE NË
MARRËVESHJEN PËR PRODHIMIN E
FURNIZIMIN NGA DHE NDËRMJET
PFIZER EXPORT BV DHE MINISTRISË
SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE TË SHQIPËRISË, MINISTRIT
TË SHETIT PËR RINDËRTIMIN DHE
INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK,
MIRATUAR ME AKTIN NORMATIV
NR. 3, DATË 18.1.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të
Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.
32, datë 5.11.2021, “Për miratimin e tekstit të disa
ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin e
furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export BV* dhe
Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të
Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe
Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin
normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të
Ministrave”.

Miratuar në datën 2.12.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13377, datë 13.12.2021,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 13377, datë 13.12.2021**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93
të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 119/2021, “Për miratimin e
aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 32, datë
5.11.2021, “Për miratimin e tekstit të disa
ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin e
furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export BV* dhe
Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të
Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe
Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin
normativ nr. 3, datë 18.1.2021 të Këshillit të
Ministrave”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 737, datë 3.12.2021

PËR MIRATIMIN E GARANCISË
SHTETËRORE, NË FAVOR TË INTESA
SANPAOLO BANK ALBANIA SHA, PËR
KONTRATËN E KREDISË NDËRMJET
INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA
SHA DHE FURNIZUESIT TË
SHËRBIMIT UNIVERSAL SHA,
OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE GROUP SHA,
PËR FINANCIMIN E KAPITALIT
QARKULLUES NË KUADËR TË
NEVOJAVE PËR IMPORT
TË ENERGJISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të
neneve 3 e 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006,
“Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe
garancitë shtetërore të huas, në Republikën e
Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 57, të ligjit
nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e
sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të
ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave



dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e garancisë shtetërore, në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania, sh.a., për kontratën e kredisë ndërmjet Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a., Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a., për financimin e kapitalit qarkullues në kuadër të nevojave për import të energjisë, në shumën 20 000 000 (njëzet milionë) euro.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSHEE Group sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Arben Ahmetaj

VENDIM

Nr. 738, datë 3.12.2021

**PËR MIRATIMIN E GARANCIVE
SHTETËRORE, NË FAVOR TË
RAIFFEISEN BANK SHA, PËR
KONTRATAT E KREDISË NDËRMJET
RAIFFEISEN BANK SHA DHE
FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT
UNIVERSAL (FSHU) SHA, OPERATORIT
TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE (OSHEE) GROUP SHA,
FURNIZUESIT TË TREGUT TË LIRË
(FTL) SHA, OPERATORIT TË SISTEMIT
TË SHPËRNDARJES (OSSH) SHA, PËR
FINANCIMIN E KAPITALIT PUNUES
NË KUADËR TË NEVOJAVE PËR
IMPORT TË ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 e 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave

dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e garancisë shtetërore, në favor të Raiffeisen Bank sh.a., për kontratën e kredisë ndërmjet Raiffeisen Bank sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Group sh.a., Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL) sh.a., Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., për financimin e kapitalit punues në kuadër të nevojave për import të energjisë, në shumën 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) euro.

2. Miratimin e garancisë shtetërore, në favor të Raiffeisen Bank, sh.a., për kontratën e kredisë, ndërmjet Raiffeisen Bank sh.a. dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Group sh.a., Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL) sh.a., Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për financimin e kapitalit punues në kuadër të nevojave për import të energjisë, në shumën 16 500 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e pesëqind mijë) euro.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe OSHEE Group sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Arben Ahmetaj



VENDIM
Nr. 761, datë 9.12.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE TË PROCEDURAVE PËR
KRIJIMIN E REZERVAVE
STRATEGJIKE TË LËNDËS DRUSORE
NË KËMBË (TË PAPRERË), RUAJTJEN
DHE TRAJTIMIN E PYJEVE TË
VIRGJËRA OSE POTHUAJSE TË
VIRGJËRA, SI DHE KALIMIN E TYRE
NË KONSERVIM TË PLOTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), si sipërfaqe pyjore të vëna në ruajtje për të përballuar ngjarje madhore, si dhe ruajtjen e trajtimin e pyjeve të virgjëra ose pothuajse të virgjëra, deri në kalimin e tyre në konservim të plotë, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.

2. Për qëllim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Ngjarje madhore”, një ngjarje ose një akt natyror apo shoqëror që ndodh në vend, si: tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmytjet, shpërthimet vullkanike, në përputhje me parashikimin e legjislacionit në fuqi;

b) “Zona me rrezikshmëri të lartë”, zonat që rrezikohen nga zjarri apo përmytjet, si dhe zonat me erozion të lartë.

3. Rezervat strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), si sipërfaqe pyjore të vëna në ruajtje për të përballuar ngjarje madhore, krijohen nga ngastrat dhe nënngastrat pyjore të cilat plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) kanë një sipërfaqe jo më pak se 10 % të sipërfaqes pyjore dhe/ose 15 % të vëllimit të lëndës drusore të pyjeve publike, në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore;

b) shfrytëzohen vetëm për plotësimin e nevojave të popullatës dhe të institucioneve publike

për furnizimin me dru zjarri e lëndë ndërtimi, në rastet e ngjarjeve madhore;

c) ndodhen afër qendrave të banuara dhe kanë shpërndarje homogjene, sipas ndarjes administrative të territorit të Republikës së Shqipërisë;

ç) përshkohen nga një rrjet rrugor funksional, i cili mundëson përdorimin e tyre në çdo kohë, si dhe nuk janë në zona me rrezikshmëri të lartë;

d) menaxhohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në planet e mbarështimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.

4. Për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), në administrim të njësisë së vetëqeverisjes vendore, ndiqet procedura, si më poshtë vijon:

a) brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet strukturave përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve, përcaktojnë ngastrat dhe nënngastrat që do të shërbejnë si rezerva strategjike të lëndës drusore në këmbë, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) propozimi i njërive të vetëqeverisjes vendore, sipas parashikimit të dhënë në shkronjën “a” të kësaj pike, dërgohet në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, e cila, pas verifikimit të përputhshmërisë së tij me Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor, brenda 2 (dy) muajve, i përcjell vlerësimin teknik strukturës përgjegjëse për pyjet në ministri;

c) struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, pasi vlerëson që përcaktimi i ngastrave dhe nënngastrave, sipas shkronjës “a”, është në përputhje me programet dhe dokumentet strategjike për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve, si dhe plotëson kriteret e këtij vendimi, brenda 20 (njëzet) ditëve, ia përcjell për miratim ministrit krijimin e rezervës strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë).

5. Në rezervat strategjike të miratuara ndalohen ndërhyrjet silvikulturore me përjashtim të prerjeve shëndetësore, kullotja, ndezja e zjarreve, dhënia në përdorim, heqja nga fondi pyjor, si dhe ushtrimi i çdo veprimtarie tjetër.

6. Ruajtja dhe trajtimi i pyjeve të virgjëra ose pothuajse të virgjëra, të cilat janë të përcaktuara në planet e mbarështimit të ekonomive, grumbujve dhe drurëve pyjorë të veçantë, të cilësuar të virgjër ose pothuajse të virgjër, realizohet sipas kriterëve të mëposhtme:



a) ruajtja e funksioneve ekologjike e mjedisore dhe evolucionit të tyre;

b) përmbushja e objektivave për mbarështimin e ekonomive, grumbujve dhe drurëve pyjorë të veçantë, të cilësuar të virgjër ose pothuajse të virgjër;

c) vendosja e masave objektive mbrojtëse për mbajtjen ose rivendosjen në një status të favorshëm ruajtjeje, për të siguruar mbrojtje afatgjatë të pyjeve të virgjëra ose pothuajse të virgjëra;

ç) përjashtimi nga shfrytëzimi dhe nga çdo lloj ndërhyrjeje tjetër që cenon statusin e tyre;

d) përputhshmëria me planet e mbarështimit.

7. Ngastrat dhe nënngastrat në pyjet e virgjëra ose pothuajse të virgjëra, të identifikuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga kadastra pyjore, kalojnë në konservim të plotë, bazuar në kriteret ndërkombëtare për konservimin e natyrës sipas IUCN (Unioni Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës), dhe trajtohen sipas rekomandimeve të planit të mbarështimit.

8. Për kalimin e pyjeve në konservim të plotë ndiqet procedura, si më poshtë vijon:

a) njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet strukturave përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve, identifikojnë ngastrat dhe nënngastrat e pyjeve të virgjëra ose pothuajse të virgjëra që do të kalojnë në konservim të plotë;

b) propozimi për kalimin në konservim të plotë të pyjeve të virgjëra ose pothuajse të virgjëra bëhet pas konsultimit me komunitetin e zonës pyjore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, shoqatat e

përdoruesve të pyjeve, ekspertët e pyjeve dhe të biodiversitetit, akademikë të shkencave të natyrës dhe të pyjeve, si dhe pas miratimit nga këshilli bashkiak i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ndodhet zona pyjore;

c) propozimi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas parashikimit të dhënë në shkronjën “a” të kësaj pike, dërgohet në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, e cila, pas verifikimit të përputhshmërisë së tij me Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor, brenda 2 (dy) muajve, i përcjell vlerësimin teknik strukturës përgjegjëse për pyjet në ministri;

ç) struktura përgjegjëse për pyjet, pasi vlerëson që përcaktimi i ngastrave dhe nënngastrave, sipas shkronjës “a”, është në përputhje me programet dhe dokumentet strategjike për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve, si dhe plotëson kërkesat e këtij vendimi, brenda 20 (njëzet) ditëve, ia përcjell për miratim ministrit propozimin për kalimin në konservim të plotë të pyjeve të virgjëra.

9. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, vendimi nr. 734, datë 1.9.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë”, shfuqizohet.

10. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Shtojca 1

BASHKIA.....

NGASTRAT E NËNNGASTRAT PYJORE TË PROPOZUARA SI REZERVË STRATEGJIKE TË LËNDËS DRUSORE

Ngastra, n/ngastra			Grumbulli pyjor							Vëllimi drusor					
Nr.	Emërtimi Ek. pyjore/kullosore	Sip. ha	Funksioni kryesor	Lloji drusor	Forma e qeverisjes	Klasa moshës	D mes cm	H mes m	Kd/Td	Për ha m³	Gjithsej për ngastër	Nga vëllimi për ngastër			
												Lëndë punimi m³	E hollë m³	E mesme m³	E trashë m³
1															
2															
3															
4															
5															
6															
7															
8															
TOTALI I BASHKISË															

**VENDIM****Nr. 762, datë 9.12.2021****PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË Z. ALI EMINI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 20, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Ali Emini, në masën 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Arben Ahmetaj****KËRKESË****Nr. 418/6, datë 14.12.2021****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ajencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave Moravë”, Njësia Administrative Otlak, Berat.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Berat.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 366 212 (treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dymbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM**Erlis Hereni**

**LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARIT TË PASURISË, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“ZGJERIMI I VARREZAVE MORAVË”, NJËSIA ADMINISTRATIVE OTLLAK, BERAT**

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Nr. i pasurisë	ZK	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja e prekur	Çmimi/njësi lekë m ²	Vlera në lekë
1	Thanas Enver Kristos	1189/25	2723	arë	1804	203	366,212
Totali							366,212

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë